



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. 1805 Prot.

Tiranë, më 07.06.2023

Lënda: Propozohet një projektligj për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi.

Drejtuar: Znj. Lindita Nikolla
KRYETARE E KUVENDIT

Tiranë

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëngjitur do të gjeni projektligjin “*Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve të minimumit jetik në Republikën e Shqipërisë*”, të shoqëruar me relacionin e tij.

Kjo nismë ligjvënëse vjen si propozim nga një grup deputetësh të Partisë Demokratike të Shqipërisë, nënshkrimet e të cilëve do t’i gjeni bashkëngjitur.

Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, kërkojmë nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin sa më parë të këtij projektligji nga Kuvendi i Shqipërisë.

Duke ju falenderuar,

PËR GRUPIN E DEPUTETËVE

Alban Kushi
Sajmir Koto



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____ 2023

PËR

**PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE TË MINIMUMIT JETIK
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 81 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton kushtet dhe kriteret për përfitimin e minimumit jetik, autoritetet përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte, si dhe marrëdhëniet e financimit të përfitimit të minimumit jetik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të përcaktojë minimumin jetik dhe përfituesit e tij, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike;
- b) të ulë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët apo familjet e prekura, si dhe të kontribuojë për integrimin e tyre;
- c) të garantojë mbështetjen e Shtetit ndaj shtresave me të ardhura të ulëta; si dhe
- ç) të organizojë bashkërendimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin e minimumit jetik.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për të gjithë individët apo familjet, të ardhurat e të cilëve janë nën pragun e minimumit jetik, pavarësisht nëse përfitojnë apo jo nga dispozitat e Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” apo nga ndonjë legjislacion tjetër i posaçëm.

Neni 4 Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Familje”, është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore, marrëdhënie prindër-fëmijë, marrëdhënie ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, të cilët jetojnë në të njëjtën strehë;

“INSTAT” ka kuptimin e Institutit të Statistikave të Republikës së Shqipërisë.

“Minimum jetik” është shuma monetare e përlogaritur sipas përcaktimeve të këtij ligji.

KREU II PËRLLOGARITJA E MINIMUMIT JETIK DHE KUSHTET E PËRFITIMIT

Neni 5 Përcaktimi i vlerës së minimumit jetik

1. Me propozim të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, të bazuar mbi studime socio-ekonomike të Institutit të Statistikave (INSTAT), Këshilli i Ministrave brenda 3-muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton me vendim vlerën e minimumit jetik në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar periudhat kohore dhe vlerat referencë të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.
2. Në përcaktimin e minimumit jetik mbahen parasysh nevojat bazë të individit për ushqim, ujë, strehim, veshmbathje, edukim dhe transport.
3. Minimumi jetik indeksohet çdo vit sipas normës së inflacionit të përcaktuar për vitin paraardhës nga Banka e Shqipërisë.

Neni 6 Referencat në shpërndarjen të përfituesit të minimumit jetik

Këshilli i Ministrave në shpërndarjen e minimumit jetik, mban në konsideratë periudhat kohore dhe vlerat referencë si vijon :

- a) Për vitin 2024, 70% të vlerës së minimumit jetik të indeksuar me normën e inflacionit;
- b) Për vitin 2025, 80% të vlerës së minimumit jetik të indeksuar me normën e inflacionit;
- c) Për vitin 2026, 90% të vlerës së minimumit jetik të indeksuar me normën e inflacionit;
- ç) Për vitin 2027 e në vijim, 100% të vlerës së minimumit jetik të indeksuar me normën e inflacionit.

Neni 7

Përfituesit e minimumit jetik

Përfituesit e minimumit jetik janë të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë banimin e tyre të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, të ardhurat e të cilëve janë nën pragun e minimumit jetik, sipas përcaktimeve të këtij ligji apo akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 8

Personat jopërfitues

Nga ky ligj nuk përfitojnë:

- a) shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit;
- b) shtetasit e huaj të cilët jetojnë në Republikën e Shqipërisë;
- c) personat që, me vendim të formës së prerë të gjykatës, vuajnë dënimin me heqje lirie, si dhe personat që trajtohen me mjekim të detyruar me vendim gjykate në institucione mjekësore të posaçme, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor.

Neni 9

Aplikimi për përfitimin e minimumit jetik

1. Kërkesa për të përfituar minimumin jetik bëhet nga:
 - a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm, kur nuk ka bashkëshort/e; ose
 - b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende vendim gjykate të formës së prerë; ose
 - c) nga vetë individi.
2. Aplikimi për të përfituar minimumin jetik bëhet tek administratori shoqëror në njësinë administrative, nën juridiksionin e së cilës personi ka vendbanimin.
3. Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e minimumit jetik, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

KREU III

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 5, pika 1 dhe nenit 9, pika 3.
2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për çështjet sociale, që, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të marrin të gjitha masat e nevojshme për organizimin dhe koordinimin me INSTAT dhe ministrinë përgjegjëse për financat për kryerjen e studimeve socio-ekonomike të nevojshme në përcaktimin e minimumit jetik.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR

PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE TË MINIMUMIT JETIK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky propozim vjen nga një grup deputetësh të opozitës si një domosdoshmëri që ka Shteti Shqiptar për të parashikuar dhe garantuar minimumin jetik në vend, si minimumi i të ardhurave të nevojshme që çdo qytetar shqiptar të mund të jetojë.

Minimumi jetik është një normë ligjore që buron nga të drejtat kushtetuese të qytetarëve. Në formulimin e minimumit jetik duhen marrë në konsideratë dhe vlerësuar drejt objektivi i sigurimit të mirëqenies së individit në përputhje me konceptin e dinjitetit njerëzor të parashikuar në Kushtetutë, në mënyrë të tillë që individi, përpos një jete dinjitoze, t'i mundësohet akses të paktën minimal në jetën kulturore, sociale dhe politike.

Duke filluar nga viti 2017 INSTAT organizon “Anketën për nivelin e të ardhurave që nxjerr treguesit e varfërisë”. Treguesit kryesore që u morën për bazën në këto llogaritje, janë:

1. Niveli i Rrezikut për të qenë i varfër, tregon përqindjen e personave që jetojnë në familje ku të ardhurat e disponueshme të ekuivalentuara janë nën kufirin e rrezikut për të qenë i varfër. Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër përfaqëson të ardhurat më të ulta vjetore të disponueshme që një person të mos konsiderohet i varfër. Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër është përcaktuar në 60 % të medianës së të ardhurave disponibël të ekuivalentuara për të gjitha familjet.

2. Privimi Material, tregon nivelin e jetesës së popullsisë nga shkalla e privimit material. Personat thellësisht të privuar materialisht janë ata që jetojnë në familje që nuk mund të përballojnë financiarisht të paktën katër nga nëntë kategoritë e privimit material të lidhura me asetet, kushtet e banimit apo aspektet financiare.

Më poshtë paraqiten kategoritë e privimit material:

- i. Vonesat në pagesat e kredisë ose të qerasë për banesën kryesore, shpenzimet për shërbimet bazë, blerjet me këste ose pagesa të tjera të kredive të marra;
- ii. Pamundësia për të përballuar shpenzimet për pushimet vjetore një javë larg nga shtëpia;
- iii. Pamundësia për të përballuar një vakt me mish, pulë, peshk (ose ekuivalentin për vegjetarianët) një herë në dy ditë;
- iv. Pamundësia për të përballuar një shpenzim të paparashikuar financiar me vlerën 000 lekë të reja;
- v. Pamundësia financiare për të përballuar një telefon (duke përfshirë telefonin celular);
- vi. Pamundësia financiare për të pasur një TV me ngjyra;

- vii. Pamundësia financiare për të pasur një makinë larëse;
- viii. Pamundësia financiare për të patur një makinë;
- ix. Pamundësia financiare e familjes për mbajtjen e shtëpisë ngrohtë në mënyrë të përshtatshme.

3. Intensiteti i punësimit në familje. Intensiteti shumë i ulët në punësim i referohet situatës së personave në familje ku asnjë nuk punon, ose punon shumë pak, që do të thotë se anëtarët e familjes në moshë pune punojnë vetëm 20 % apo më pak se numri gjithsej i muajve që ata mund të punonin gjatë periudhës së referencës.

Më poshtë janë treguesit e varfërisë të publikuar nga EUROSTAT deri në vitin 2020. Të dhënat për vendet e Europës janë deri në 2021 kurse për Shqipërinë deri në 2020. Sipas EUROSTAT, dy indikatorët që merren për referencë janë fëmijët nën 18-vjeç me rrisht varfërie dhe përjashtimi social si dhe individët e tjerë me rrisht varfërie dhe përjashtimi social.

Nga ky studim i EUROSTAT, Shqipëria renditet vendi i parë në Europë si dhe në rajon me rrisht më të lartë për varfëri dhe përjashtim social për moshën nën 18 vjeç. Për fëmijët nën 18 vjeç niveli i varfërisë në vitet 2019 dhe 2020 ishte respektivisht 53.9 dhe 51%. Për sa i takon personave madhorë në vend që sipas EUROSTAT preken nga varfëria, në vitet 2019 dhe 2020 ishte respektivisht 50.8 dhe 46.2%.

Këto shifra tregojnë se niveli i varfërisë në vend mbetet një problem mjaft serioz dhe endemik, i cili kërkon politika të guximshme në mënyrë që situata në vend të ndryshojë dhe varfëria të zbutet.

Në këto kushte, minimumi jetik duhet të bëhet pjesë kryesore e sistemit kombëtar të mbrojtjes shoqërore dhe shëndetësore, duke reflektuar nevojat e individëve dhe familjeve jo vetëm për ushqim, por edhe për aktivitete të tjera të zhvillimit njerëzor. Trajtimi i minimumit jetik nuk duhet parë si një barrë për ekonominë dhe buxhetin e Shtetit apo pengesë për zhvillimin ekonomik, por si faktor i zhvillimit ekonomik e social.

Mungesa e këtij definicioni e bën Shqipërinë pjesë të grupit të atyre vendeve që nuk mund të garantojnë apo sigurojnë në mënyrë efektive burimet e jetesës bazë së qytetarëve. Parimet kushtetuese që formojnë bazën e shtetit shqiptar, janë dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore (neni 3 i Kushtetutës së RSH).

Në vendin tonë ende mungon një përkufizim i qartë dhe i saktë i minimumit jetik i përcaktuar në legjislacionin për mbrojtjen sociale, gjë që ndikon në hartimin e politikave për mbrojtjen sociale, sidomos në përcaktimin e qartë të qëllimit të këtyre politikave. Investimi në politika të tjera, si politika e arsimit, shëndetit apo punësimit që konsiderohen si politikë që ndikojnë më shumë në zbutjen e varfërisë dhe daljen nga varfëria, nuk ka ardhur në rritje, përkundrazi është më i ulët në rajon. Sot, rreth gjysma e popullsisë në vendin tonë (49%) janë në rrezik varfërie ose jetojnë me të ardhura shumë të ulëta (UN Country Report for Albania, 2020).

Nga studime të ndryshme minimumi jetik konsiderohet një pagesë e nevojshme për të mundësuar mbijetesën bazuar në një kosto reale jetese, pjesëmarrjen lirisht në jetën sociale e kulturore të vendit, pra, të sigurohen garancitë e qytetarëve në drejtim të sigurimit të mjeteve të tyre të jetesës.

Në mënyrë të përmbledhur, gjatë 33 viteve të fundit janë kryer disa analiza/studime mbi këtë çështje. Në Shqipëri në vitet e fundit të regjimit komunist (1989), minimumi jetik llogaritej 450 lekë për familje në muaj. Me ndryshimin e sistemit, studimi i parë për përcaktimin e minimumit jetik u ndërmor në vitin 1991 nga Ministria e Ekonomisë dhe Instituti i Studimeve të Ekonomisë në të cilin rezultoi 870 lekë për familje. Janw bwrw disa pwrpjekje për llogaritjen e minimumit jetik si ajo e vitit 2001 të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ku minimumi jetik u përlllogarit 7,975 lekë në muaj për frymë, mw tej janw bwrw vlerësime institucionale nga INSTAT për kufirin e varfërisë për frymë, i cili u përcaktua në vlerën 4,891 lekë (2002); 5,272 lekë (2005); 5,722 lekë (2008) dhe 6,047 (2012).

Kontribut në këtë fushë kanë dhënë dhe studiues të tjerë të pavarur. Sipas profesorit Ilia Telo, minimumi jetik për frymë llogaritej të ishte 9,058 lekë në muaj në vitin 1998. Përlllogaritja e fundit te këtëj treguesi u bë në vitin 2011 nga studiuesi Kiço Ziso, i cili e përlllogariti minimumin jetik në nivelin e 15,072 lekëve në muaj për frymë.

Referuar studimit më të kompletuar për Minimumi jetik të financuar nga Avokati i Popullit rezultoi se Minimumi Jetik për frymë në Shqipëri sipas metodës absolute në vitin 2015 rezultoi të jetë 16,000 lekë në muaj (7,089 lekë në muaj për shpenzimet ushqimore dhe 8,913 lekë në muaj për shpenzimet jo-ushqimore). Në ndryshim nga studimet e tjera mbi nivelin e minimumit jetik, vlera e përcaktuar nga ky studim merr në konsideratë edhe aspekte sociale dhe tendencat e konsumit në vendin tonë me qëllim sigurimin e një minimumi jetik sa më të përshtatshëm. Duke indeksuar këtë vlerë të minimumit jetik, rezulton se sipas studimit të Avokatit të Popullit, minimumi jetik ne 2023 duhet te jete: 18800 leke ne muaj per fryme.

Gjithashtu, nëse marrim parasysh faktin që pjesa më e madhe e të ardhurave shkojnë për të mbuluar shpenzimet për ushqime dhe faktin që rritja e çmimeve të shportës së konsumit ka qenë tejet e lartë gjatë 3 viteve të fundit, analizat tregojnë se kjo vlerë është akoma edhe më e lartë duke tejkaluar madje edhe kufirin e **200 euro në muaj**.

Nisur nga sa më sipër, ky propozim ka për qëllim të rregullojë mënyrën e dhënies së minimumit jetik, për të garantuar mbrojtje e domosdoshme sociale për të gjithë qytetarët vulnerabël të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social ekonomike.

Objektivat që synohen të arrihen në lidhje me skemën e minimumit jetik, kanë të bëjnë me:

- I. Administrimin dhe funksionimin për herë të parë në Shqipëri të një skeme të minimumit jetik;
- II. Parashikimin e procedurave të thjeshta dhe transparente për përcaktimin e vlerës monetare të minimumit jetik si dhe kalendarin e përditësimit të tij;

III. Përcaktimin e detyrave dhe roleve e të gjithë institucioneve të përfshira, të tilla si ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale dhe financat publike, Këshilli i Ministrave, INSTAT etj.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve, por ai vjen si nismë e një grupi deputetesh të opozitës, me qëllim forcimin e mbrojtjes sociale ndaj qytetarëve shqiptarë në pamundësi për të garantuar të ardhurat minimale për të përballuar kostot e jetesës në vend.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësia e projektligjit, sikundër rezulton dhe nga përmbajtja e tij është propozimi i krijimit për herë të parë në Shqipëri të skemës së minimumit jetik.

Në kuadrin e nevojës së ndërtimit të një shtylle evropiane të të drejtave sociale, ka përpjekje nga shtetet evropiane, me gjithë diferencat e tyre, që të garantojnë një nivel të caktuar dinjiteti mes qytetarëve. Konkretisht, së fundmi ka pasur disa iniciativa konkrete nga Bashkimi Evropian për forcimin dhe modernizimin e sistemeve të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale.

Në majin Mars të vitit 2021 Komisioni Evropian prezantoi *Planin e Veprimit lidhur me të drejtat Sociale*. Ky plan veprimi parashikon adoptimin e një rekomandimi të Këshillit të BE lidhur me të ardhurat minimale në vitin 2022, duke theksuar se kushdo me të ardhura të pamjaftueshme ka të drejtën e të ardhurave minimale për të garantuar një jetë me dinjitet. Nëpërmjet aderimit në instrumentat ndërkombëtarë për të drejtat ekonomike dhe sociale si Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale apo Karta Sociale Evropiane shtetet marrin përsipër detyrimin për të respektuar, mbrojtur dhe garantuar të drejtat ekonomike dhe sociale të qytetarit.

Minimumi jetik duhet të konsiderohet një barrierë për të garantuar një “vlerë minimale absolute të nevojshme për një jetesë dinjitoze”. Shtetet duhet marrin përsipër detyrimin për të garantuar plotësimin e niveleve minimale jetike të të drejtave, pavarësisht nga niveli i zhvillimit të tyre ekonomik.

Në Angli ekziston i sanksionuar minimumi jetik kombëtar, ndërsa Italia dhe Spanja llogarisin minimumin jetik bazuar në koston e jetesës për një shportë ushqimore që llogaritet nga baza e të dhënave të FAOs. Në Shtetet e Bashkuara, pragu i varfërisë përditësohet çdo vit nga Byroja e Regjistrimit. Në Gjermani, qeveria e klasifikon një individ si në rrezik për të rënë në varfëri nëse të ardhurat e tij janë më pak se 60% të mesatares së të ardhurave në nivel kombëtar.

Në legjislacionin e vendeve Evropiane trajtohen dy elementë paralel që plotësojnë njëra-tjetrën:

Së pari një nivel minimumi jetik i përcaktuar në shifra konkrete me ligj ose akt tjetër nënligjor i cili shikohet si garanci për qytetarët dhe si një kufi varfërie i paprekshëm, dhe

Së dyti, me kusht që ky referim mos ngelet thjesht i sanksionuar në akt, por i pa aplikueshëm, një sërë mekanizmesh ligjorë, të ndryshueshëm dhe të vazhdueshëm se si orientohen shtetet që ky rregullim të prek direkt secilin qytetar të vendit respektiv, ndërmjet skemave të ndryshme që ata zgjedhin të aplikojnë.

Përcaktimi i treguesit zyrtar të minimumit jetik është bërë domosdoshmëri dhe për zbatimin e rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare, si Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore.

Prandaj, edhe në Shqipëri është e nevojshme përcaktimi me ligj i detyrimit për llogaritjen e minimumit jetik dhe të ngarkohen institucionet përgjegjës me këtë detyrë, duke reflektuar në legjislacion nevojën për indeksimin e këtij treguesi çdo vit. Ky minimum jetik të përdoret në themel të hartimit të Politikave Sociale për shtresat në nevojë.

Për sa i përket detajimit në vlerë të saktë me shifra të këtij minimumi, për shkak të dinamikës së ndryshimit të tij, i cili lidhet me ndryshimin e çmimeve, kostove të jetesës, dhe shumë elementëve të konsumit të përditshëm, sanksionimi i kësaj vlere, me ligj, do të ishte i pa volitshëm. Ndaj në projektligj është parashikuar që Ministria e linjës duhet të jetë në këtë rast organi i cili, duke ju referuar vlerësimeve dhe studimeve të marra nga INSTAT, duhet t'i propozojë Këshillit të Ministrave përcaktimin e minimumit jetik.

Sfidat me të cilat duhet të përballen shtetet lidhur me pragun e varfërisë nuk mjaftohen në përcaktimin e një niveli minimumi jetik. Ky nivel duhet të jetë i arritshëm dhe i mundshëm për këdo. Pasi të sanksionohet me një normë ligjore niveli i minimumit jetik, një shtet ka detyrimin të prek dhe një sërë legjislacionesh të tjera sociale dhe buxhetore, për të mundësuar zbatimin e plotë dhe efektiv të këtij standardi tek qytetarët dhe familjet.

Prandaj edhe në Shqipëri, sanksionimi i një minimumi jetik si më sipër, dhe lindja e detyrimit së pari nga institucionet shtetërore për ta siguruar këtë minimum, kërkon dhe ndryshimet përkatëse në disa akte ligjorë ekzistues, kryesisht legjislacionin social. Në hartimin e këtyre politikave, shteti shqiptar duhet të ketë në vëmendje standardet e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale dhe të Kartës Sociale Evropiane dhe, gjithashtu, të vlerësojë qasjen me standardet e Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit të integritimit.

Efektet e pritshme të projektligjit në tërësi janë: Rritja e sigurisë së të ardhurave të ligjshme i familjeve dhe individëve në nevojë, ulja e riskut që individë nën pragun e minimumit jetik të bien pré e trafiqeve dhe krimet të organizuar për shkak të vulnerabilitetit të tyre për të siguruar të ardhurat minimale për të jetuar, rritja e numrit të lindjeve, mbështetja e familjeve në nevojë, përmirësimi i treguesve arsimor dhe shëndetësor të personave, etj.

IV. VLERESIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar jo vetëm që është në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe me parimet e sanksionuara në të, por në vlerësimin tonë është një instrument ligjor i nevojshëm për të realizuar qëllimin kësaj nisme.

Parashikime të ngjashme mbrojtjeje janë plotësisht në përputhje me Kushtetutën dhe janë në harmoni me rendin juridik vendas.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me paketën ligjore *acquis* të Bashkimit European. Sidoqoftë, theksojmë se Bashkimi European promovon fuqishëm marrjen e masave të menjëhershme për zvogëlimin e varfërisë si dhe siç e thekojmë në hyrje të prezantimit të kësaj nisme, thuajse të gjithë vendet e zhvilluara të BE parashikojnë mekanizma të ngjashëm lidhur me minimumin jetik për qytetarët e tyre.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban gjithsej 11 nene, të ndara në tre kapituj.

Kreu i parë i këtij projektligji ka 4 Nene dhe përmban Dispozitat e Përgjithshme, ku krahas objektit, qëllimit dhe fushës së zbatimit të ligjit, parashikohen gjithashtu edhe disa përkufizime.

Kreu II përmban thelbin e dispozitave të këtij ligji. Kështu, neni 5 i titulluar “Përcaktimi i vlerës së minimumit jetik”, parashikon mënyrën e përcaktimit të minimumit jetik. Sipas dispozitës, minimumi jetik propozohet, “Me propozim të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, të bazuar mbi studime socio-ekonomike të Institutit të Statistikave (INSTAT)”, dhe ky propozim përcaktohet e miratohet më pas nga “Këshilli i Ministrave brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji (...) duke respektuar periudhat kohore dhe vlerat referencë të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji”. Neni 6 jep referencat në shpërndarjen e minimumit jetik, duke sanksionuar si vijon:

“Këshilli i Ministrave në shpërndarjen e minimumit jetik, mban në konsideratë periudhat kohore dhe vlerat referencë si vijon :

- a) Për vitin 2024, 70% të vlerës së minimumit jetik të indeksuar me normën e inflacionit ;*
- b) Për vitin 2025, 80% të vlerës së minimumit jetik të indeksuar me normën e inflacionit*
- c) Për vitin 2026, 90% të vlerës së minimumit jetik të indeksuar me normën e inflacionit;*
- ç) Për vitin 2027 e në vijim, 100% të vlerës së minimumit jetik të indeksuar me normën e inflacionit”.*

Në nenet 7 dhe 8 të projektligjit parashikohen respektivisht kategoritë e përfituesve të minimumit jetik dhe personat jopërfitues. Sipas parashikimit të projektligjit, “Përfituesit e minimumit jetik janë të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë banimin e tyre të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, të ardhurat e të cilëve janë nën pragun e minimumit jetik, sipas

përcaktimeve të këtij ligji apo akteve nënligjore të dala në zbatim të tij". Ndërkohë që personat e përjashtuar nga përfitimet e këtij ligji do të jenë:

"a) shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit;

b) shtetasit e huaj të cilët jetojnë në Republikën e Shqipërisë;

c) personat që, me vendim të formës së prerë të gjykatës, vuajnë dënimin me heqje lirie, si dhe personat që trajtohen me mjekim të detyruar me vendim gjykate në institucione mjekësore të posaçme, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor".

Neni 9 parashikon procedurat që duhen ndjekur për përfitimin e minimumit jetik. Këto procedura parashikojnë se:

"1. Kërkesa për të përfituar minimumin jetik bëhet nga:

a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm, kur nuk ka bashkëshort/e; ose

b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martesë dhe nuk ka ende vendim gjykate të formës së prerë; ose

c) nga vetë individi.

2. Aplikimi për të përfituar minimumin jetik bëhet tek administratori shoqëror në njësinë administrative, nën juridiksionin e së cilës personi ka vendbanimin.

3. Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e minimumit jetik, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji".

Kreu II i projektligjit parashikon dy dispozita, respektivisht nenin 10 i cili përcakton afatet dhe autoritetet që duhet të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji. Ndërkohë që neni 11 dhe i fundit i projektligjit parashikon dispozitën e zakonshme për hyrjen në fuqi të ligjit, 15-ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij ligji janë Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, ministria e përgjegjëse për financat, INSTAT, si dhe institucionet e tjera ligjzbatuese të cilat kanë për detyrë zbatimin e këtyre dispozitave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga grupi i deputetëve të opozitës të cilët kanë nënshkruar atë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Vlerësojmë që ky projektligj mund të ketë efekte financiare për buxhetin e shtetit, si pjesë e kontributit në këtë fond. Vlera e këtij efekti financiar mund të përlllogaritet pasi Këshilli i Ministrave të ketë vendosur mbi vlerën financiare të minimumit jetik.

DEPUTETËT

Bujan Leskaj Buzaj

Edi PALOKA

Flamur Nohi

Albano Veli

Loq Berisha

Tectin Shk

Edmond Spacia Enata

Ima Zhupa

ISUF ECANA
Jakovik Hosur

Serim Koto

Juan Baci

Yeto Sedeli

Aslan Dajani

Dejd Bylykbotu

Karim Mahmutaj

Koristrot Jiroli

Elida Hati

2022